

Shoqata është e organizuar në 22 degë vendore, duke përfshirë anëtarësinë në komunën e Tetovës dhe gjashtë komuna rurale. Ajo i ka trupat dhe organet vendimmarrëse, të cilat i shqyrtojnë dhe miratojnë Programet vjetore të punës, të cilat me përkushtim zhvillohen brenda vitit

I lindur në vitin 1952 në fshatin Xhermë të Tetovës, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Tetovë, ndërsa studimet universitare në Shkup, duke u diplomuar si profesor i lëndës së fizikës. Punoi në fushën e arsimit në disa shkolla tetëvjeçare dhe të mesme në Tetovë, ndërsa një pjesë të shekullit të punës e kaloi si edukator në Shtëpinë edukuese-përmirësuese në Tetovë, ndërsa një periudhë ishte edhe gjykatës-porotë në Gjykatën Themelore të Tetovës. Pensionohet në vitin 1993 dhe që atëherë angazhohet në aktivitetet e Shoqatës së pensionistëve të Tetovës. Nga viti 2019 zgjidhet Kryetar i Shoqatës, të cilin funksion e ushtron edhe sot e kësaj dite.

Intervista u zhvillua në kulmin e aktiviteteteve të SHP-Tetovë, të cilave si gjithnjë u prinë pikërisht kryetari Memeti.

Cili ishte motivi që ju shtyri të aktivizoheni në SHP-Tetovë?

-Dëshira, vullneti dhe përcaktimi për të kontribuar në organizimin pensional të pensionistëve tetovar, me qëllim të ngritjes së nivelit për një jetë më aktive të moshave të treta. Besoj se në këtë rrafsh kam arritur të kontribuojë në masë të duhur, të cilën e dëshmon edhe anëtarësia më e gjerë.

Cilat janë aktivitetet kryesore që zhvillohen në kuadër të Sho-

INTERVISTË ME SELVER MEMETI - KRYETARI I SHP-TETOVË

PENSIONISTËT E TETOVËS, TË ORGANIZUAR PËR NJË JETË MË AKTIVE



qatës së pensionistëve të Tetovës?

Aktivitetet janë të shumta, por do të veçoja zhvillimin e aktiviteteve kulturore, sportive, ekskursione në vend dhe në shtetet fqinje, aktivitetet ekologjike, bashkëpunimi me institucionet lokale e qendrore, bashkëpunimi me Shoqatat simotra, bashkëpunimi me Kryqin e Kuq komunal, me qendrën spitalore të Tetovës, etj.

Po cili është organizimi i brendshëm i Shoqatës?

Shoqata është e organizuar në 22 degë vendore, duke përfshirë anëtarësinë në komunën e Tetovës

dhe gjashtë komuna rurale. Ajo i ka trupat dhe organet vendimmarrëse, të cilat i shqyrtojnë dhe miratojnë Programet vjetore të punës, të cilat me përkushtim zhvillohen brenda vitit. Kuvendi dhe Këshilli ekzekutiv janë organet më të larta drejtuese të Shoqatës, ndërsa Komisionet janë trupa ndihmës që trajtojnë çështje nga fusha e tyre, siç janë aktivitetet kulturore, sportive, shëndetësore, statutare, etj.

Çfarë do të veçonit nga sukseset që ka arritur Shoqata gjatë periudhës së kaluar?

Lirisht mund të pohoj se Shoqata jonë e pensionistëve, gjithnjë në të kaluarën ka arritur rezultate kulminante të ndryshme të vepimit. Grupet tona folklorike, si në prezantimet rajonale ashtu edhe në ato Republikane, me dinjitet kanë prezantuar këngën, vallen, doket dhe traditën e këtyre trevave. Këtë vit bie fjala, si rezultat i prezantimeve të shkëlqyeshme kulturore, grupet tona folkloristike do të marrin pjesë në Festivalin ndërkombëtar të moshave të treta në Lubjanë, me 28 dhe 29 Shtator të këtij viti.

Këtë vit LSHPM e shënoi 80-vjetorin e themelimit të organizimit pensional në Maqedoni. Cili ishte kontributi juaj në këtë manifestim?

Është e vërtetë se me 22 Prill të këtij viti në Shkup u shënuar 80-vjetori i themelimit të organizimit pensional në Maqedoni. Në këtë jubile, laureatë të çmimit të parë mbi organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteteve të pensionistëve ishte Kryetari i SHP-të Velesit dhe Kryetari i SHP të Tetovës, Selver Memeti. Pra isha unë, ndonëse këtë mirënjohje ia dedikoj gjithë Shoqatës së pensionistëve të Tetovës, e cila me përkushtim i përmbush të gjitha obligimet mbi bazën e planeve dhe programeve vjetore. Besoj se në këtë drejtim do të vazhdohet edhe në të ardhmen.

Gjithsesi për t'i realizuar të gjitha aktivitetet e planifikuara, Shoqata duhet të ketë bashkëpunim me institucione e shoqata të tjera. Si qëndron puna me Shoqatën tuaj?

Gjithsesi, Shoqata jonë ka kohë

që ka krijuar një kornizë të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet lokale të komunës së Tetovës, me shoqata e asociacione të tjera komunale, por edhe me institucione të nivelit qendror. Bashkëpunimi ynë me komunën e Tetovës është i nivelit të lartë. Po kështu bashkëpunojmë me Qendrën spitalore të Tetovës, me Kryqin e Kuq komunal, me SPB Tetovë dhe me shumë organizata shoqërore të nivelit lokal. Gjithashtu kemi bashkëpunim me institucione shkollore, veçmas me Universitetin shtetëror të Tetovës. Bashkëpunimet në të ardhmen do të ngrihen në nivele edhe më të larta.

Një aktivitet i rëndësishëm pensional është edhe organizimi i ekskursioneve me njerës të moshave të treta. Çfarë mundësish u krijohen pensionistëve për pjesëmarrje në këtë aktivitet masiv pensional?

Po, është e vërtetë, ne si Shoqatë një kujdes të veçantë i kushtojmë organizimit të ekskursioneve me pensionistë në vend dhe jashtë shtetit. Brenda vitit këtë mundësi e shfrytëzojnë rreth 2.000 pensionistë anëtar të Shoqatës sonë. Ekskursionet realizohen sipas Programit vjetor të Komisionit përkatës, ndërsa vizitohen qendrat urbane më karakteristike brenda shtetit si dhe ekskursione që realizohen tek shtetet fqinje. Vizitohen qytete në Shqipëri, Serbi, Kosovë, Bosnjë e Hercegovinë, etj. Gjatë realizimit të ekskursioneve Shoqata angazhon edhe mjek specialist i cili kujdeset për shëndetin e pensionistëve pjesëmarrës të ekskursionit. Intervistoi: Mursel Murseli

SHP GJORÇE PETROV

Mirënjohje për Kryqin e Kuq për angazhimin gjatë vapës

Me rastin e përballimit me sukses të valëve të të nxehtit që kanë zgjatur për disa javë dhe madje muaj, SHP Gjorçe Petrov shpreh mirënjohje publike për Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë, dhe mirënjohje të veçantë për Kryqin e Kuq të Qytetit të Shkupit, si dhe për organizatat komunale në territorin e qytetit të Shkupit. Në këto temperatura të larta të papara të verës që kalojnë 40 gradë, Kryqi i Kuq i Qytetit të Shkupit, në bashkëpunim me organizatat komunale, reagoi menjëherë duke dërguar vullnetarë nga klubi rinor që shpërndanë shishe me ujë të ftohtë në rrugët e qytetit, dhe veçanërisht në stacionet e autobusëve ku frekuenca është më e lartë. Në këtë kategori njerëzish, një numër më i madh janë pensionistë ose nga popullata e moshuar.

Me këtë rast, po paraqesim një pjesë të vogël të aktiviteteteve të Kryqit të Kuq të ndërmarrë gjatë gjithë vitit.

Gjatë periudhave të temperaturave të larta, dhe në kuadër të aktiviteteteve për t'u përballur me valët e të nxehtit, Kryqi i Kuq kryen aktivitete që synojnë parandalimin, informimin dhe mbrojtjen e popullsisë, me fokus të veçantë në kategoritë më të prekshme të qytetarëve.

Aktivitetet përfshijnë informimin në kohë të popullsisë rreth rreziqeve nga temperaturat e larta dhe rekomandimet për mbrojtje, si dhe ndarjen e këshillave për hidratimin e duhur, shmangien e ekspozimit të drejtpërdrejtë në diell dhe zvogëlimin e aktivitetit fizik gjatë pjesës më të nxehtë të ditës.

Ekipet mobile të Kryqit të Kuq, në përputhje me planin e veprimit dhe rekomandimet e institucioneve kompetente për t'u përballur me valët e të nxehtit, veprojnë në terren duke shpërndarë ujë tek qytetarët në vende të shpeshta dhe vende me lëvizje të shtuar të popullsisë me qëllim nxitjen e hidratimit të rregullt dhe zvogëlimin e rrezikut të pasojave të shkaktuara nga temperaturat e larta. Gjatë shpërndarjes së ujit, qytetarët informohen edhe për masat themelore për mbrojtje nga vala e të nxehtit, shmangien e ekspozimit të drejtpërdrejtë në diell, qëndrimin në dhoma të freskëta dhe pirjen e lëngjeve të mjaftueshme.

Aktiviteti ka natyrë parandaluese dhe është pjesë e përpjekjeve të Kryqit të Kuq për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e po-



pullsisë gjatë periudhave të temperaturave jashtëzakonisht të larta. Ljubinko Ristov